

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295
E-mail info@kesh.al
Ueb-faqe www.kesh.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF : 20634-02-24-2022

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Platforma për menaxhimin e shit-blerjes së energjisë si dhe modulet mbështetëse".

5. Fondi limit: 155,000,000 (Njëqind e pesëdhjetë e pesë milion) Lekë pa TVSH ose 1,278,561 (Një milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24/02/2022 është 121.23 Lekë/Euro.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

✚ Afati kohor për zbatimin e këtij projekti do të jetë 30 ditë, nisur nga data e nënshkrimit të kontratës.

✚ Mirëmbajtja do të jetë 1 (një) vit nga momenti i lëshimit të Çertifikatës së marrjes në dorëzim të sistemit.

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 18/03/2022 Ora: 10:00.

Afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42 pika 6 të LPP shkurtohet pasi :

Me qëllim përballimin dhe parandalimin e krizës së energjisë elektrike e cila ka filluar të shfaqet në shumë vende të botës, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë me anë të VKM nr 584, datë 08.10.2021 "Për Shpalljen e Gjëndjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike" ka shpallur gjëndjen e emergjencës për sektorin e energjisë.

Në vijim të këtij qëllimi, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë me VKM nr 757, datë 09.12.2021 "Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 620, datë 22.10.2021, të Këshillit të

Ministrave “Për Miratimin e Kushteve për Vendosjen e Detyrimit të Shërbimit ndaj të Licencuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike gjatë gjëndjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike dhe për Përballimin dhe Parandalimin e saj” e ngarkon Kompaninë Kesh sh.a. që për qëllime të furnizimit me të gjitha sasi të nevojshme për nevojat e furnizuesit të shërbimit universal ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë të shkëmbejë/depozitojë apo të kryejë transaksione shit-blerje të energjisë në tregun e lirë.

Në zbatim të akteve të mesiperme, KESH sh.a. ka filluar importin e energjisë elektrike për plotësimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. prej datës 1 Janar 2022 dhe në vijim. Me qëllim optimizmin e kostove të blerjes së energjisë elektrike, KESH sh.a. është i detyruar të ndjekë në dinamikë çmimet e bursave të energjisë elektrike dhe në vijim të hapë procedura të blerjes së energjisë elektrike. Ky proces është shumë i shpeshtë brenda javës/muajit, pasi edhe nevoja për energji elektrike nga FSHU sh.a. është e ndryshueshme në varësi të konsumit të vendit. Në kushtet e mësipërme, dhe ku prioritet ka sigurimi i energjisë elektrike me kosto sa më të ulët është e nevojshme që procesi i blerjes së energjisë elektrike të bëhet me platformë elektronike, kjo me qëllim kapjen në kohë më të shpejtë të sinjaleve të tregut të energjisë elektrike si dhe rrjedhimisht uljen e kostove për blerje energjie elektrike.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho